

	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government</p> <p style="text-align: center;">Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova Ministry of Internal Affairs</p> <p style="text-align: center;">Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police</p> <hr/> <p style="text-align: center;">Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Generalna Policijska Direkcija / General Police Directorate</p>	
---	---	---

MEMORANDUM ZYRTAR - SLUŽBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM

Prishtinë,
24.01.2018, 08:30

KONFERENCA E PESTË NDËRKOMBËTARE

“AUDITIMI I SIGURISË RRUGORE DHE ZVOGËLIMI I AKSIDENTEVE NË TRAFIK”

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për ftesën në këtë konferencë, e vlerësojë si një mënyrë të veçantë e cila kontribuon në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor.

Rrugët janë një aset i rëndësishëm publik të cilat kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe krijimin e vendeve të punës duke ofruar lidhje thelbësore të cilat sigurojnë lëvizjen e mallrave, shërbimeve dhe lëvizjen e njerëzve, ato u ofrojnë komuniteteve qasje, lidhje brenda vendit dhe në shtete të ndryshme. Rrjedhimisht, temat të cilat ndikojnë në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugorë në Kosovë dhe në rajon në përputhje me “Dekadën e Veprimit për Sigurinë në Rrugë 2011-2020” të OKB-së, janë shumë të rëndësishme për nxitjen e standardeve më të mira të sigurisë në vend.

Ashtu siç jemi në njohuri se parandalimi dhe zvogëlimi i aksidenteve në trafikun rrugor, tash e sa vite nuk është vetëm sfidë e shoqërisë dhe vendit tonë, por, tashmë është një shqetësim i madh global, aksidentet në shumicën e vendeve të botës janë vrasësi më i madh i njerëzve.

Faqe 1 nga 4

Në këtë kontekst sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) brenda një viti në aksidente trafiku vdesin 1.2 milion njerëz. Dekada e Veprimit për Siguri në Rrugë (2011–2020) ka për qëllim të shpëtojë miliona jetë duke përmirësuar sigurinë e rrugëve dhe automjeteve, duke përmirësuar sjelljen / kulturën e njerëzve në trafik dhe duke përmirësuar shërbimet e emergjencës. Sipas saj, parashihet që deri në vitin 2020 numri i personave të vdekur në aksidente trafiku të ulet në 50 %.

Nga fillimi i implementimit të rekomandimeve të dala nga Dekada e Veprimit për Siguri në rrugë 2011-2020 nga Policia e Kosovës kemi tendencë pozitive që afrohet me synimet e përcaktuara. Në këtë kontekst në vitin 2011 kanë ndodhur 130 aksidente fatale, ku 157 persona kanë humbur jetën. Ndërsa, në vitin 2017, numri i aksidenteve fatale ka rënë në 122 ndërsa numri i personave që kanë humbur jetën 137, apo 20 persona më pak, që i bien se për një periudhë shtatë vjeçare kemi arritur rënie të aksidenteve për - 5.38%. Ndërsa, viti 2017 krahasuar me vitin 2016 ka ngritje të aksidenteve fatale 23.23%, kurse rënie të numrit të përgjithshëm të aksidenteve për -4.56%.

Krahasimi i aksidenteve në Kosovë për Janar-Dhjetor 2016/2017

Janar-Dhjetor 2016		Janar-Dhjetor 2017		(+/-)	%
Aksidente fatale	99	Aksidente fatale	122	23	23.23
Persona të vdekur	110	Persona të vdekur	137	27	24.55
Aksidente me lëndime	6130	Aksidente me lëndime	6390	260	4.24
Personat e lënduar	12009	Personat e lënduar	12645	636	5.30
Aksidente me dëme	12312	Aksidente me dëme	11183	-1129	-9.17
Total aksidente	18541	Total aksidente	17695	-846	-4.56
Tiketa të shqiptuara	326515	Tiketa të shqiptuara	396924	70409	21.56

Porse, vlen të theksohet se me hyrjen në fuqi të pjesës së Ligjit për Kundërvajtje, Policisë së Kosovës ju kanë shtuar kompetencat. Në këtë drejtim nga data 01.01.2018 ka filluar së funksionuari Komisioni për Vendosje në Policinë e Kosovës, i cili është formuar konform Ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.




Tabela 1. Statistikat për vendet evropiane dhe të Ballkanit të marra nga WHO

Ky komision ka detyrë të shqyrtojë ankesat e qytetarëve kundërvajtës të cilëve ju shqiptohen masa nga zyrtarët policor ndaj kundërvajtjes që ata kanë bërë dhe atë në shumë deri në 500€ për persona fizik dhe 1000€ për persona juridik, përfshirë edhe pikët negative, ndalimin e drejtimit të mjetit motorik për një periudhë të caktuar kohore, konfiskimin e patentë shoferit etj.

Rrjedhimisht, vlerësojë se dhënia e kompetencave Policisë së Kosovës, do të ndikojnë në ngritjen e sigurisë në trafikun rrugor, kështu duke ulur numrin e aksidenteve, me theks të veçantë atyre me fatalitet.

Nga ulja e numrit të aksidenteve gjatë viteve të fundit (2011-2016) Kosova krahasohet në mënyrë të favorshme me vendet e rajonit apo edhe me disa nga shtetet anëtare të BE-së. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO), në 100.000 banor Kosova është e renditur me 6.9 aksidente fatale, Maqedonia 6.9, Mali i Zi 10.4, Shqipëria 20.4, Bosnja me 8.7, Serbia 7.5, dhe Kroacia me 8.2 aksidente.

Siguria rrugore është një përgjegjësi e përbashkët, e cila nuk i takon vetëm një institucioni, Policisë ose vetëm Qeverisë. Ajo duhet të përfshijë të gjithë akterët, OJQ-të, ekspertet dhe profesionistët e kësaj lëmie.

Ndërsa, duke e vlerësuar konferencën në fjalë, mendojë se është një kontribut i rëndësishëm për agjendën e sigurisë rrugore dhe një shembull se si ngjarjet publike të sponsorizuara nga sektori privat mund të rrisin ndërgjegjësimin në trafik.

Shpresoj se kjo konferencë do të japë rekomandime për të përmirësuar më tej standardet e sigurisë rrugore në Kosovë, bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe të vendeve të tjera të BE-së.

Policia e Kosovës si gjithmonë do të ndjekë politikë "zero tolerancë" ndaj të gjithë kundërvajtësve në trafikun rrugor, me qëllim të rritjes së sigurisë rrugore.

Ju faleminderit!

Me respekt

Kolonel Sheremet Ahmeti
Drejtor i Divizionit të Komunikacionit Rrugor
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës